

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 18, datë 31.8.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 18, DATË 1.7.2020, “PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TE SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar; dhe të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 1.7.2020, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Në kreun III, bëhen këto ndryshime:

i. Pika 3, ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Shtëpitë botuese/distributorët duhet të lëshojnë për zyrën vendore të arsimit parauniversitar përkatëse, faturën tatimore të shitjes, sipas legjislacionit në fuqi, për sasinë e teksteve shkollore të shitura pjesë e katalogut, sipas porosisë së kryer nga çdo institucion arsimor i sistemit parauniversitar, pasi të kenë rakorduar me këto të fundit për të gjitha kategoritë që përfitojnë tekste shkollore falas.”.

ii. Në pikën 6, togfjalëshi “të klasave VIII dhe IX dhe arsimin e mesëm të lartë” zëvendësohet me togfjalëshin “të arsimit të mesëm të lartë”.

b) Pas pikës 3, të kreut IV, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Përfundimisht, për vitin shkollos 2021–2022, afatet e kërkesave nga institucionet arsimore dhe ZVAP-të, paraqiten brenda datës 15.9.2021.”.

c) Formulari nr. 1 zëvendësohet me formularin me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Formular nr. 1

Kërkesë e shkollës _____ drejtuar ZVAP-së, për mbështetje me fonde buxhetore për shtëpitë botuese/distributorët në “arsimin bazë”

Nr.	Emri, mbiemri i nxënësit/prindërit	Emri/shkolla	Klasa 1-9	Statusi i përfitimit, sipas pikës 6, të VKM- së, mbështetur në vendimet e njësisë së pushtetit vendor	Fatura nr. , datë e shtëpisë botuese	Nr. i NIPT-it të shtëpisë botuese “Drita”, “Dielli”, “Hëna” etj.	Sasia e teksteve të blera/copë	Vlera e teksteve, në lek (shuma që konfirmohet prind/nxënësi, në lek)	Nr. dokumenti i identitetit për prindin që konfirmon marrjen/pajisjen me tekste shkollore nga prindi/në emër të nxënësit	Emri, mbiemri, nënshkrimi për prindin që konfirmon pajisjen me tekste shkollore të fëmijës/nxënësit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ermal Dritan Peto	Delvinë	I	Pikës “a”	Nr. 15, datë 1.9.2018	J21424005 U	5	2.800	Plotësohet ditën kur tërhiqen tekstet shkollore	Plotësohet datën kur tërhiqen tekstet në klasë/shkollë
2	Denisa Paskal Naqe	Delvinë	I	Pikës “b”	Nr. 15, datë 1.9.2018		5	2.800		
		Delvinë	I	etj.						
25	Orion Sokol Vrap	Delvinë	I		Nr. 8, datë 2.9.2018		5	2.500		
					TOTALI			8.100		